REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER HELENA B. SHËNGJERGJI (VAKO)
ADRESA NR.10, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.6, NR.8, NR.3
TEL: 682080755

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 2036** **Nr. koleksioni: 345**

**Tirane më 28/12/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021052860040683689

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

A2021052860040683689

# KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 28-12-2021, para meje Notere HELENA B. SHËNGJERGJI(VAKO), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.6, NR.8, NR.3, u paraqit personalisht:

**DHURUES:**
**Erald Zajmi,** atësia Gezim, amësia Fatbardha, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Qemal Stafa; Nd. 63; H. 8; Ap. 5; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 06/07/1984, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Nr. BA6185067 dhe nr. personal I40706063O, zotërues i nje kuote, me vlere kapitali Para: 34.000,00, Pjesëmarrja në përqindje (%), 34, ne shoqërinë tregetare "ALBANIAN MATERIALS AND ENERGY MANAGEMENT COMPANY shpk me NUIS: L81408510S.

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhururesi**")*

**PRANUES I DHURIMIT:**
Indrit Daja, atësia Qemal, amësia Pranvera, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Jeronim De Rada; Nd. 1; H. 21; Ap. 34; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë, lindur më 09/02/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034324255 dhe nr. personal H90209045U, zotesues i nje kuote, me vlere kapitali Para: 66.000,00, Pjesëmarrja në përqindje (%), 66, ne shoqerine tregetare "ALBANIAN MATERIALS AND ENERGY MANAGEMENT COMPANY shpk me NUIS: L81408510S.

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfituesi i dhurimit**")*

**Rrethanat e hartimit të aktit noterial:**

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotës të kapitalit.

**Objekti i Kontratës:**

Objektin e kësaj kontrate e përben dhurimi i 1 (një) kuote, pjesë e zotëruar nga dhuruesi që përbën 34 % (tridhjetekatër) të kapitalit themeltar të shoqërisë "ALBANIAN MATERIALS AND ENERGY MANAGEMENT COMPANY ShPK me NUIS: L81408510S, me vlere kapitali 34.000 (tridhjetekatërmijë) lek tek përfituesi dhe pranimin e dhurimit nga Pranuesi i dhurimit

**1. Përmbajtja e kontratës:**

A. Në përputhje me Statutin e shoqërisë "ALBANIAN MATERIALS AND ENERGY MANAGEMENT COMPANY" ShPK me NUIS: L81408510S, Dhuruesi z. Erald Zajmi zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 34 (tridhjetekatër) %, të kapitalit themeltar të shoqërisë Erald Zajmi Shpk, me vlere kapitali 34.000 (tridhjetekatërmijë) Lek ja dhuron pranuesit te dhurimit z. Indrit Daja
B. Pranuesi i Dhurimit, Z. Indrit Daja falënderon z. Erald Zajmi, dhe shprehet se pranon dhurimin e 34 (tridhjetekatër) %, të kapitalit themeltar, të shoqërisë ALBANIAN

MATERIALS AND ENERGY MANAGEMENT COMPANY" shpk me NUIS: L81408510S me vlere kapitali 34.000 (tridhjetekatermije) Lek

C. Pas këtij transaksioni Z. Erald Zajmi nuk do të zotërojë asnjë pjesë, asnjë kuotë dhe asnjë përqindje pjesëmarrjeje në shoqërinë ALBANIAN MATERIALS AND ENERGY MANAGEMENT COMPANY" shpk me NUIS: L81408510S

D. Me pranimin e këtij dhurimi **Ortaku Indrit Daja** behet ortak i vetëm i shoqërisë, zotërues i (1) nje kuote, me pjesëmarrja në përqindje (%), 100 % (njeqindperqind) me vlere kapitali 100.000 (njëqindmijë) LEK ne shoqërinë tregtare ALBANIAN MATERIALS AND ENERGY MANAGEMENT COMPANY" ShPK me NUIS: L81408510S

**2. Detyrimet Tatimore të Dhurimit**

a. Detyrimet tatimore, që lindin nga kjo kontratë do të llogariten dhe do të paguhen në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar

**3. Deklarimet dhe Garancitë**

Dhuruesi deklaron dhe garanton Pranuesit e Dhurimit si më poshtë;

a. Dhuruesi posedon kuotat të lira nga çdo barrë siguruese, peng, hipotekë, garanci pagese, barrë mbi interesat, kufizim, opsion, pretendim, prokurë apo angazhime të tjera të çdo lloj natyre (secila me poshtë "Barrë")
b. Nënshkrimi i kësaj kontrate nga Dhuruesit dhe plotësimi i kushteve të saj nuk përbëjnë shkelje apo janë në kundërshtim me normat e (i) statutit të Shoqërisë, (ii) ndonjë gjykim apo urdhër, vendimi gjyqësor, dekreti apo vendimi të cdo autoriteti vendas apo të huaj subjekt i të cilit janë Dhuruesit, (iii) ndonjë marrëveshjeje, licence apo angazhimi në të cilin Dhuruesit apo Shoqëria janë palë, që do të cenonte aftësinë e tyre për të nënshkruar këtë kontratë apo për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej saj, (iv) me ligjin e zbatueshëm
c. Ka te gjitha aftësitë juridike për te nënshkruar ketë kontrate dhe nuk ka asnjë pengese ligjore e cila do te cenonte dhurimin

**4. Forca madhore**

i.. Mos përmbushja e kësaj kontrate nga njëra palë nuk do të konsiderohet si shkelje e kësaj kontrate përsa kohë që mos përmbushja vjen si pasojë e një ngjarje të konsideruar si Forcë Madhore, në rastin kur provohet se pala e prekur nga kjo ngjarje (a) ka marrë të gjitha masat e arsyeshme parandaluese, si dhe të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur kushtet dhe afatet e kësaj kontrate dhe (b) ka informuar palën tjetër në mënyrë të menjëhershme për ndodhjen e kësaj ngjarje. Forcë Madhore do të konsiderohet çdo urdhër, rregullore, direktivë e qeverisë e shpallur në formën e një ligji apo në një formë tjetër, apo cdo lloj sanksioni me natyrë kombëtare apo ndërkombëtare, trazirë, kryengritje popullore, luftë (e deklaruar apo jo) aksione terroriste apo guerrilase të grupeve apo të individëve të veçante, greva apo shqetësime të tjera të kësaj natyre, zjarre tërmete apo cdo lloj shkaku tjetër, që nuk varet nga vullneti i palëve ose nuk vjen si pasoje e neglizhencës së tyre dhe që ata nuk kishin mundësi ta parashikonin.

ii.Çdo periudhë kohe brenda së cilës njëra prej palëve, bazuar në këtë kontratë do të ndërmarrë ndonjë veprim do të zgjatet në një mënyrë të barabartë me periudhen e kohës në të cilën pala e kishte të pamundur të vepronte si pasojë e Forcës Madhore. Në rastet kur ngjarjet e Forcës Madhore zgjaten më shumë se tre muaj rresht, secila palë mund ta zgjidhë në mënyrë të njëanshme këtë kontratë, pa asnjë penalitet.

A20210528600406836S9

**5. Klauzola shtesë**

a. Kjo Kontratë bëhet në pese kopje origjinale, me 3 (tre) faqe te lidhura me vulë të njomë midis tyre, nga të cilat një kopje do depozitohet dhe regjistrohet në QKB, një kopje për tu regjistruar tek Regjistri i pronareve përfitues, menjëherë me nënshkrimin e saj, nga nje kopje Dhuruesi, një kopje secili Pranuesi të Dhurimit, dhe nje kopje për tu ruajtur ne arkivin noteriale. Mos regjistrimi i kësaj kontrate ne QKB brenda afatit ligjor i ngarkon me penalitete palet.

b. Kjo Kontratë përfaqëson marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e kutotave si më sipër dhe asnjë kusht i saj nuk do të amendohet, anullohet ose shfuqizohet, përveç sa parashikohet nga kjo Kontratë.

**6. Hyrja në fuqi**

Kjo Kontratë hyn në fuqi sot në datën e nënshkrimit te saj nga dhuruesi dhe pranuesit e dhurimi. Kontrata redaktohet në bazë të nenit 761 e vijues të K. Civil dhe ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” Për çfarë nuk parashikohet në këtë kontratë do të aplikohen dispozitat referuese të K. Civil.

Unë noteri deklaroj se mora autorizimin për përdorimin e të dhënave personale të palëve dhe se të dhënat e përdoruara nga unë në këtë dokument do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin e redaktimit të këtij akti dhe regjistrimit te tij ne NISA. Përpunimi i të dhënave në akt do të bëhet në respektim të plotë dhe zbatim rigoroz të dispozitave të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” Nr. 9887, datë 10/03/2008, i ndryshuar".

Shpenzimet noteriale për redaktimin e kësaj kontrate përbehen nga 3.000 Lek tarife Shërbimi + 700 lek pulle tarife e cila i aplikohet kopjes se aktit qe ruhet ne arkivin noterial.

Kontrata për dhurimin e kuotës ju lexua me zë te larte dhe qarte nga unë noteri palëve, te cilët deklaruan se e kuptuan, i kuptuan efektet juridike te saj, e gjeten ne përputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe e nënshkruajnë rregullisht përpara meje. Unë noteri e vërtetoj sipas ligjit.

**DHURUES:**

Erald Zajmi

**PRANUES I DHURIMIT:**

Indrit Daja

**NOTER**

HELENA B. SHËNGJERGJI(VAKO)

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L81408510S |
| 2. Data e Regjistrimit | 08/02/2018 |
| 3. Emri i Subjektit | ALBANIAN MATERIALS AND ENERGY MANAGEMENT COMPANY |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 06/02/2018 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 06/02/2018 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Durres RRASHBULL RRASHBULL Fshati Vrrine, Godine 1- Kateshe, Zona Industriale, nr.pasurie 22/36, zona kadastrale 3339 |
| 8. Kapitali | 100.000,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 2,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Menaxhim, trajtim, transport, shit-blerje lende te para, mbetje, nenprodukte industriale dhe urbane. Konsulenca ne fushen e mjedisit, sigurimit teknik, menaxhimit te integruar te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, hartime te Raporteve te VNM/VNMS dhe eficençes se energjise. Hartim Projektesh dhe zbatim te Impianteve te trajtimit te ujrave teknologjik dhe te ndotur. Trajtim i mbetjeve te ngurta dhe te lengeta te tjera. Laborator testues dhe kalibrues. Analiza kimike te mineraleve ferroze dhe jo ferroze, testime ne fushen e mjedisit dhe shkarkimeve industrial ne toke, uje, ajer, zhurmave, vibrimeve, rrezatimit jonizues & Radioaktivitetit. Studim fizibiliteti, hartim i plan bizneseve, kartave teknologjike. Menaxhim i PPP. Vleresim Risku dhe pergatitje e Raporteve te VR ne Mjedis e Pune. Projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te gjelbra, lulishte e parqe, plane rehabilitimi per miniera nentokesore, miniera ne qiell te hapur dhe objekte te mbrojtjes kunder zjarrit, plane evakuimi, plane emergjencash. Trajnime te ndryshme per fushat e mesiperme. Konsulenca ne fushen e Akreditimit/Certifikimit sipas standarteve ISO, EN, CEN/TS, BS. |
| 10. Administratori/ët<br>10.1 Afati i emërimit | Erald Zajmi |

Kopje e QKB web

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB

| | | |
|---|---|---|
| | Nga: 12/05/2018 | Deri: 01/09/2023 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore<br>11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | IndritDaja | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 66.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 66,00 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 13. Ortakët | EraldZajmi | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 34.000,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 34,00 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: ALBANIAN MATERIALS AND ENERGY MANAGEMENT COMPANY<br>E-Mail: Albanian.mem.co@gmail.com<br>Telefon: 0693667777 | |
| 16. Statusi: | Aktiv | |

Kopje nga web

Datë: 28/12/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20211228162654225 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 28.12.2021 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 4:26:54PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-629-445 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

ERALD GEZIM ZAJMI
ALBANIAN MATERIALS AND ENERGY MANAGEMENT COMPANY SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE ALBANIA

Gerta Mtlulla